



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 224

Tiranë – E hënë, 21 nëntor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 7642, datë 17.11.2016	Për procedurat e ekzekutimit mbi njësitë individuale që përbëjnë strukturën që do të ndërtohet dhe për të cilat disponohen kontrata sipërmarrjeje/porosie..... 22933
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 522, datë 1.11.2016	Për mbylljen e veprimtarisë së Shkollës së Mesme Jopublike, Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm (Gjimnaz), “Guinnes”..... 22933
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 67, datë 11.11.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 361, datë 13.5.2016 të Këshillit të Ministrave..... 22934
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 68, datë 14.11.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 5 (13-2012-118), datë 11.1.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 10-2012-1142 (410), datë 11.7.2012, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2014-500, datë 3.4.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 22939
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 69, datë 14.11.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2016-796 (183), datë 24.3.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë..... 22944
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 121, datë 9.11.2016	Për disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”..... 22951
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 122, datë 9.11.2016	Për një ndryshim në rregulloren “Për instrumentet e pagesave elektronike”..... 22952
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 123, datë 9.11.2016	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Societe Generale Albania sh.a..... 22952

Kërkesë e Ministrisë së
Transportit dhe Infrastrukturës
nr. 5445, datë 9.11.2016

Për shpronësim, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken
nga projekti “Rrugët zëvendësuese M03 për ndërtimin e hidrocentralit të
Moglicës”, për pasuritë e llojit “truell”, “arë” dhe “kullotë” 22953

**UDHËZIM****Nr. 7642, datë 17.11.2016****PËR PROCEDURAT E EKZEKUTIMIT
MBI NJËSITË INDIVIDUALE QË
PËRBËJNË STRUKTURËN QË DO TË
NDËRTOHET DHE PËR TË CILAT
DISPONOHEN KONTRATA
SIPËRMARRJEJE/POROSIE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, si dhe të nenet 46 dhe 47, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Të gjithë përbaruesit gjyqësorë privatë dhe publikë në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e këtij udhëzimi si vijon:

1. Kur në përfundim të procedurave përbarimore, karabinaja kalon në pronësi të një kreditori dhe në regjistrin e veçantë nuk është regjistruar asnjë akt tjetër noterial, ose kontratë sipërmarrjeje/porosie/premtim shitjeje, sipas nenit 46, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, regjistruesi lëshon dokumente të përkohshme në favor të kryerjes së transaksioneve nga ana e kreditorit, i cili ka të drejtë të disponojë dhe të tjetërsojë me të tretët këtë pasuri, vetëm për ato njësi ndërtimore që janë të lira dhe nuk kanë akte noteriale të regjistruara më parë mbi to.

2. Në rastet kur në regjistrin e veçantë ku është i regjistruar objekti si karabina, janë të regjistruara kontrata sipërmarrjeje/porosie/premtim shitjeje, apo çdo akt tjetër noterial për njësitë ndërtimore të individualizuara, pjesë të strukturës së karabinasë, përbaruesi nuk mund të vendosë sekuestro mbi këto njësi ndërtimore të individualizuara, objekt i këtyre kontratave.

3. Në rastet kur disponohet një kontratë sipërmarrjeje/porosie/premtim shitjeje, apo çdo akt tjetër noterial, i paregjistruar në regjistrin e veçantë në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, por vërtetohet se porositi/blerësi ka kryer pagesa në zbatim të kontratës së

sipërmarrjes/porosisë/premtim shitjes apo çdo akti tjetër noterial, përbaruesi gjyqësor nuk mund të vendosë sekuestro mbi këto njësi ndërtimore, objekt i këtyre kontratave dhe nëse e ka vendosur, duhet të marrë masa të menjëhershme për përjashtimin apo heqjen e sekuestros nga këto njësi.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit dhe Dhoma Kombëtare e Përbaruesve Gjyqësorë Privatë, të orientojë përbaruesit gjyqësorë të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

URDHËR**Nr. 522 , datë 1.11.2016****PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË
SHKOLLËS SË MESME JOPUBLIKE,
ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM
(GJIMNAZ), “GUINNES”**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së Shkollës së Mesme Jopublike, Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm (Gjimnaz), “Guinnes”.

2. Institucioni arsimor jopublik i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, ka këto detyrime:

a) Të mbyllë të gjitha detyrimet lidhur me veprimtarinë mësimore për vitin akademik 2016–2017, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

b) Të pajisë çdo nxënës me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar, brenda datës 21.11.2016.

c) Të vendosë në dispozicion të njësisë arsimore vendore përkatëse, çdo informacion të kërkuar dhe të komunikojnë me to deri në



plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të përcaktuara në këtë urdhër.

d) Të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbyshur që mund të kenë ndaj nxënësit.

e) Të dorëzojë në njësinë arsimore vendore përkatëse të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer.

f) Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri, të përballohen nga institucioni përkatës i arsimit parauniversitar jopublik.

3. Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë (qytet) ka për detyrë:

a) Të ngrenë brenda datës 30.11.2016, një grup pune për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri nga institucioni i përcaktuar në pikën 1. Grupi i punës të menaxhojë transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar publik ose privat.

b) Të ruajnë në arkivin e tyre dhe në vijim të arkivojnë sipas ligjit për arkivat, të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni, i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë të gjitha masat, sipas parashikimeve të Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për personin juridik, që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1, i cili nuk zbaton këtë urdhër.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit t’i kërkojë Qendrës Kombëtare të Licencimit kryerjen e veprimeve ligjore për çregjistrimin e subjektit, që përfaqëson Shkollën e Mesme Jopublike, Arsimit i Mesëm i Përgjithshëm (Gjimnaz), “Guinness”.

6. Ngarkohen për zbatimin e urdhrit Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë (qytet) dhe subjekti juridik përfaqësues i institucionit i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

VENDIM

Nr. 67, datë 11.11.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datat 12.7.2016 dhe 19.7.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr. 41 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Shukri Xhelili, përfaqësuar nga avokat Ferdinand Doja.

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar me autorizim në gjykim nga Artur Metani.

Objekti: Shfuqizimi si i papajtuësishëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 361, datë 13.5.2016 të Këshillit të Ministrave.

BAZA LIGJORE: Neni 115/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, që kërkoj pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Shukri Xhelili është zgjedhur kryetar i Bashkisë Dibër në zgjedhjet lokale të zhvilluara në vitin 2015.

2. Me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 361, datë 13.5.2016,



e ka shkarkuar kërkuesin nga detyra e kryetarit të bashkisë për shkak të shkeljeve të rënda. Ky vendim ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 17.5.2016¹.

3. Kërkuesi në datën 25.5.2016 ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 361, datë 13.5.2016, të Këshillit të Ministrave si të papajtueshëm me Kushtetutën.

II

4. **Kërkuesi Shukri Xhelili** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar shfuqizimin e vendimit objekt shqyrtimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me argumentet si vijojnë:

4.1. Vendimi i shkarkimit nga detyra ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi nuk i është dhënë mundësia të njihet me shkeljet e ngarkuara dhe arsyet e shkarkimit, si dhe të realizojë të drejtën e mbrojtjes.

4.2. Kërkuesi nuk është njohur zyrtarisht me relacionin për shkeljet e ngarkuara, si dhe arsyet e shkarkimit.

4.3. Kërkuesi nuk është njohur me procedimin disiplinor dhe nuk ka pasur mundësi të paraqesë prapësimet e mundshme, duke u cenuar e drejta për t'u mbrojtur dhe parimi i kontradiktoritetit. Si për çdo akt administrativ dhe për marrjen e vendimit të shkarkimit duhet të respektoheshin procedurat administrative.

4.4. Në vendim citohet se shkak i shkarkimit është për shkelje të rënda, pa specifikuar nëse janë shkelur dispozitat konkrete të Kushtetutës apo të ligjeve.

5. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka paraqitur prapësime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

5.1. Me vendimin nr. 361, datë 13.5.2016, Këshilli i Ministrave e ka shkarkuar nga detyra kryetarin e Bashkisë Dibër për shkelje të rënda të Kushtetutës dhe ligjeve. Vendimi është marrë pas shqyrtimit të pamjeve filmike të publikuara në një prej emisioneve televizive, ku kërkuesi shfaqet duke kryer veprime joetike, të cilat cenojnë rëndë figurën e zyrtarit dhe ulin besimin e publikut në institucionin e drejtuar prej tij.

5.2. Pretendimi i kërkuesit se shkarkimi është

rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor, pasi i është mohuar e drejta të njihet me shkeljet e ngarkuara dhe arsyet e shkarkimit, si dhe e drejta të mbrohet, është i pabazuar.

5.3. Kërkuesi ka shkelur nenin 4/2, të ligjit 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", duke dëmtuar rëndë figurën e zyrtarit publik me veprime që nuk janë në përputhje me misionin e vetëqeverisjes vendore dhe në shkelje të ushtrimit të rregullt të funksionit të zyrtarit. Kërkuesi ka shkelur ligjin e mësipërm, pasi nuk ka respektuar parimet themelore për punësimin e punonjësve, si dhe ka shkelur Kodin e Punës duke cenuar personalitetin dhe dinjitetin e punëmarrësit.

5.4. Pretendimi se akti i shkarkimit ka të meta është i pabazuar. Ai është marrë në përputhje me nenet 100 dhe 115 të Kushtetutës dhe nenin 62/a, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", është votuar nga Këshilli i Ministrave dhe është nënshkruar nga Kryeministri, pas shqyrtimit të relacionit përkatës.

5.5. Pretendimi për mosnjohim të aktit të shkarkimit është i pabazuar pasi vendimi së bashku me relacionin, me shkresën nr. 3134 prot., datë 16.5.2016, i janë dërguar kërkuesit në adresën e tij.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuesit

6. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se vendimi për shkarkimin nga detyra të organit të qeverisjes vendore është një akt individual i natyrës administrative. Në rastin e shkarkimit nga detyra të organit të qeverisjes vendore, kushtetutëbërësi, në mënyrë që t'u japë garanci më të mëdha në ushtrimin e detyrës këtyre organeve, në nenin 115/2 të Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e tyre për t'u ankuar drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit Gjykata shqyrton drejtpërdrejt vetëm kushtetutshmërinë e akteve me karakter normativ (*shih vendimet nr. 32, datë 10.7.2013, nr. 23, datë 25.7.2013; nr. 15, datë 8.6.2009; nr. 22, datë 7.10.2008; nr. 39, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se bazuar në nenin 115 të Kushtetutës kërkuesi legjitimohet *ratione materiae* dhe *ratione personae*.

¹ Fletore Zyrtare nr. 81, 17 maj viti 2016.



7. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, Gjykata vëren se bazuar në nenin 115/2 të Kushtetutës organi i shkarkuar mund të ankohet brenda 15 ditëve në Gjykatën Kushtetuese.

8. Gjykata është shprehur se si datë e fillimit të afatit të ankimit ndaj aktit individual, që cenon të drejtat e personit, do të konsiderohet data e marrjes dijeni nga personi për ekzistencën e aktit, pavarësisht formave të tjera të publikimit (*vendimi nr. 37, datë 25.7.2013 i Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në çështjen në shqyrtim kërkuesi pretendon se nuk ka marrë dijeni më parë për vendimin e shkarkimit, si rrjedhim, si datë e marrjes dijeni do të llogaritet data 17.5.2016 e botimit të vendimit të shkarkimit në Fletoren Zyrtare. Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur në datën 25.5.2016. Duke iu referuar kësaj date rezulton se kërkuesi ka respektuar afatin 15-ditor të ankimit para kësaj Gjykate dhe për këtë arsye legjitimohet *ratione temporis*.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor

10. Kërkuesi Shukri Xhelili ka pretenduar se vendimi i shkarkimit nga detyra e kryetarit të Bashkisë Dibër është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, pasi nuk është vënë në dijeni për shkaqet e shkarkimit, si dhe nuk i është krijuar mundësia për t'u mbrojtur para organit administrativ. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se vendimi i shkarkimit nuk plotëson standardet e parimit të arsytimit të vendimit.

11. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter disiplinor administrativ. Në këtë kuptim, ajo ka theksuar se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt si një e drejtë themelore (*shih vendimet nr.*

23, datë 25.7.2013; nr. 32, datë 10.7.2013; nr. 15, datë 3.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Kjo e drejtë realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe parashtrimit të argumenteve prej tij, ose avokatit të zgjedhur. Në nenin 44 të Kodit të Procedurave Administrative (KPA) parashikohet se çdokush që ka interes të ligjshëm, ka të drejtë të marrë pjesë në procedimin administrativ². Palët pjesëmarrëse në një procedim administrativ janë autoriteti kompetent, nga njëra anë dhe pala e interesuar nga ana tjetër. Gjykata gjatë këtij gjykimi vlerëson kushtetutshmërinë, procedurën dhe ligjshmërinë e shkarkimit të ndjekur nga organi administrativ. Në këtë gjykim secila nga palët ka detyrimet e veta procedurale. Pala kërkuese ka detyrimin të argumentojë karakterin antikushtetues të vendimit, ndërsa pala e interesuar të përcaktojë veprimet ose mosveprimet që përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimet nr. 30, datë 28.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese; nr. 22, datë 7.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nisur nga rrethanat e çështjes në shqyrtim, Gjykata vlerëson se për shkarkimin e kërkuetit nga detyra e kryetarit të Bashkisë Dibër organi administrativ nuk ka respektuar elementet procedurale të procesit të rregullt ligjor si njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi dhe respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes nga organi administrativ.

14. Gjykata çmon se pretendimi i subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, se shkarkimi i kërkuetit nga detyra e kryetarit të Bashkisë Dibër ka ndodhur në kushtet e urgjencës, nuk është i bazuar.

15. Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes, në respektim të standardit për një proces të rregullt ligjor, i krijoi mundësi kërkuetit, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, për t'u njohur me shkeljen e ngarkuar. Kërkuesi nëpërmjet përfaqësuesit të tij, edhe gjatë zhvillimit të dy seancave plenare iu

² Në çështjen konkrete gjejnë zbatim dispozitat e ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative". Kodi i ri i procedurave administrative, ligji nr. 44/2015 ka hyrë në fuqi në datën 28.5.2016 dhe akti objekt gjykimi është i datës 13.5.2016.



krijua mundësia për të realizuar mbrojtjen në respektim të parimit të kontradiktoritetit nëpërmjet parashtrimit të argumenteve dhe paraqitjes së provave, duke rivendosur të drejtat dhe interesat e cenuara prej organit administrativ.

16. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 361, datë 13.5.2016, i Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra nuk është i arsyetuar, pasi nuk është argumentuar nëse kërkuesi ka kryer shkelje të rëndë të Kushtetutës apo ligjeve.

17. Gjykata konstaton se vendimi nr. 361, datë 13.5.2016 është bazuar në relacionin dhe propozimin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Në pikën 4, të VKM-së nr. 584, datë 28.8.2003, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave” parashikohet se ministrat të drejtën e nismës për projektakt e ushtrojnë në përputhje me fushat e veprimtarisë shtetërore që kanë në kompetencë, si dhe me përgjegjësitë që burojnë nga strategjitë dhe dokumentet e tjera të miratuara për drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore. Kryeministri e ushtron këtë të drejtë në çdo rast, kryesisht ose kur kjo e drejtë nuk është ushtruar nga ministri përkatës, sikurse është vepruar në rastin konkret.

18. Në relacionin e Kryeministrit, i cili, bazuar në nenin 25, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, është pjesë e pandarë e përmbajtjes së vendimit të shkarkimit, rezulton i pasqyruar i gjithë informacioni mbi faktet që janë bërë shkak për marrjen e vendimit dhe që kanë përligjur shkarkimin e kërkuetit nga detyra. Për këto arsye, vendimi objekt kundërshtimi është i arsyetuar në përputhje me nenin 109 të KPA-së, në të cilin parashikohet se arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuetit për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit të shkarkimit nuk është i bazuar.

19. Nisur nga rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata e sheh me vend të rritshëm se në çdo rast të fillimit të procedurave administrative për shkarkimin e organeve të zgjedhura nga Këshilli i Ministrave duhet të respektohen elementët e së drejtës për një proces të rregullt.

20. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuetit për

cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor është i pabazuar³.

C. Për pretendimin e shfuqizimit të vendimit nr. 361, datë 13.5.2016, të Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra

21. Kërkuesi ka pretenduar se është shkarkuar nga detyra e kryetarit të Bashkisë Dibër në mungesë të shkaqeve të parashikuara nga neni 115/1 i Kushtetutës, pasi ai nuk ka kryer sjellje dhe akte që bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjin.

22. Gjykata vëren se në nenin 115 të Kushtetutës, në nenet 41/1/ç, 42, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar⁴, si dhe në nenin 62/a, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” përcaktohet se mandati i kryetarit të bashkisë përfundon përpara afatit në rastin e shkarkimit me vendim të Këshillit të Ministrave kur kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve.

23. Gjykata është shprehur se gjykimi, i cili ka për objekt shkarkimin nga detyra të organeve të qeverisjes vendore, është gjykim në themel i kërkesës dhe ajo, si organ kontrolli, për të çmuar shkeljen e rëndë të Kushtetutës apo ligjit, heton dhe gjykon në themel çështjen, ashtu siç do të vepronte një gjykatë e sistemit gjyqësor të zakonshëm (*shih vendimet nr. 15, datë 8.6.2009; nr. 22, datë 7.10.2008; nr. 39, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Duke qenë se shkarkimi/shpërndarja e organeve të zgjedhura të qeverisjes vendore është një masë ekstreme e procedurave të kontrollit, ajo duhet të merret pas një vlerësimi të kujdesshëm të disa elementeve të zhvilluara në jurisprudencën e kësaj Gjykate, sipas së cilës kuptimi i saktë dhe i drejtë i konceptit shkelje e rëndë e ligjit vlerësohet në tërësinë e tij nga disa faktorë, të cilët kanë të bëjnë me rëndësinë e ligjit të shkelur, pasojat e ardhura nga shkelja e tij,

³ Gjyqtari S.Berberi mban qëndrimin se gjatë procedurave vendimmarrëse në KM nuk janë respektuar disa kërkesa që imponon procesi i rregullt ligjor, por këto shkelje janë korrigjuar gjatë gjykimit kushtetues. Për këtë arsye ka votuar kundër kërkesës së kërkuetit për shfuqizimin e vendimit të KM-së, objekt shqyrtimi.

⁴ Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.3.2004 dhe nr. 30/2015, datë 2.4.2015.



kohëzgjatjen e këtyre pasojave, si dhe vetë qëndrimin subjektiv që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer (*shih vendimet nr. 15, datë 3.5.2011; nr. 15, datë 8.6.2009; nr. 22, datë 7.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata konstaton se shkarkimi i kërkuesit nga detyra e kryetarit të Bashkisë Dibër ka ardhur pas shfaqjes së pamjeve filmike në një prej emisioneve televizive, ku ai shfaqej në veprime joetike duke i kërkuar favore seksuale njëres prej punonjëseve të institucionit që ai drejtonte. Nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, u paraqitën si provë materiale: urdhri i kryetarit të Bashkisë Dibër nr. 118, datë 1.10.2015, “Për miratimin e strukturës organizative të qendrës kulturore të Bashkisë Dibër; kopja e vendimit nr. 25, datë 26.2.2016, “Për emërimin në detyrë të shtetases A.A.”; kopja e kontratës së punësimit; lista e pagesave për muajt shkurt, mars, prill, maj dhe qershor të viti 2016 të shtetases A.A.; vendimi nr. 584, datë 28.8.2003, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”.

26. Për t'i dhënë mundësi kërkuesit për të paraqitur argumente dhe prova për të mbështetur pretendimin e tij, Gjykata e ka shtyrë seancën për një datë tjetër. Në seancën gjyqësore të datës 19.7.2016, përfaqësuesi i kërkuesit paraqiti në cilësinë e provës procesverbalin e marrjes së të dhënave nga personi që tregon rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, konkretisht të shtetases A.A., e cila ka sqaruar rrethanat e njohjes, komunikimet dhe takimet me kërkuesin. Në parashtrimet shtesë të paraqitura, përfaqësuesi i kërkuesit ka argumentuar se aparati me të cilin është realizuar filmimi është asgjësuar, gjë e cila pohohet dhe gjatë marrjes në pyetje të shtetases së dëmtuar (*fajja 4, paragrafi 6 i procesverbalit*). Sipas tij, veprimet që i atribuohen kërkuesit janë objekt procedimi penal dhe si rrjedhojë është gjykata e zakonshme që do të vendosë mbi fajësinë apo pafajësinë e tij.

27. Detyra e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse shkaku që ka shërbyer për shkarkimin nga detyra të organit të zgjedhur të qeverisjes vendore përbën ose jo shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve dhe jo oportunitetin e masës së marrë. Të drejtën për të vlerësuar marrjen ose jo të masës së shkarkimit nga detyra, kur janë të pranishme kushtet e përcaktuara në

nenin 115 të Kushtetutës, kushtetutëbërësi e ka lënë në çmimin e Këshillit të Ministrave kur shprehet se ky i fundit mund të shpërndajë ose të shkarkojë organin e zgjedhur drejtpërdrejt të qeverisjes vendore për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve (*shih vendimet nr. 32, datë 10.7.2013, nr. 23, datë 25.7.2013; nr. 15, datë 8.6.2009; nr. 22, datë 7.10.2008; nr. 39, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Lidhur me pretendimin e kërkuesit se çështja është në hetim dhe është gjykata penale që do të përcaktojë fajësinë e tij, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se si rregull përgjegjësia penale konkurren me përgjegjësinë administrative apo disiplinore. Veç kësaj, pavarësisht nga procedimi penal, organi administrativ, Këshilli i Ministrave, mund të nisë njëherazi një procedurë administrative për shkelje për të cilat konstatohet përgjegjësi administrative (*shih vendimet nr. 32, datë 10.7.2013; nr. 22, datë 7.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesi është i pabazuar.

29. Gjykata vlerëson se veprimet e kryera nga kërkuesi kanë cenuar rëndë figurën e zyrtarit publik, misionin e qeverisjes vendore, kompetencat e kryetarit të bashkisë, si dhe vijnë në kundërshtim me nenin 32 të Kodit të Punës, në të cilin parashikohet se punëdhënësi respekton dhe mbron në raportet e punës personalitetin e punëmarrësit. Ai duhet të parandalojë çdo qëndrim që cenon dinjitetin e punëmarrësit. Punëdhënësi ndalohet të kryejë çdo veprim që përbën shqetësim seksual karshi punëmarrësit dhe nuk lejon kryerjen e veprimeve të tilla nga punëmarrësit e tjerë.

30. Kjo gjykatë edhe në jurisprudencën e saj ka theksuar se sjelljet që dëmtojnë rëndë figurën e zyrtarit publik sipas ligjit për qeverisjen vendore i ka cilësuar si shkelje të rënda të ligjit (*shih vendimin nr. 15, datë 3.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Si pjesë e kontrollit kushtetues të aktit të shkarkimit nga detyra të kërkuesit, gjykata shqyrton edhe qëndrimin subjektiv të kërkuesit ndaj shkeljes së ngarkuar. Gjatë seancës gjyqësore nga përfaqësuesi i kërkuesit u pranua vërtetësia e njërit prej filmimeve të zhvilluara në automjetin e kërkuesit, ku ai shfaqej duke kërkuar favore seksuale ndaj shtetases A.A., me



premtimin për ndryshimin e pozicionit e saj të punës në institucionin e drejtuar prej tij.

32. Si përfundim, Gjykata vlerëson se shkeljet që i janë ngarkuar kërkuesit Shukri Xhelili janë të rënda, në kuptim të nenit 115/1 të Kushtetutës, për pasojë kërkesa për shfuqizimin e vendimit nr. 361, datë 13.5.2016, të Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Dibër është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 115/ 2, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 68, datë 14.11.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 6.7.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 40 Akti, që i përket:

KËRKUES: Armand Llakaj, Marjus Tafa

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 5 (13-2012-118), datë 11.1.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 10-2012-1142 (410), datë 11.7.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2014-500, datë 3.4.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/f dhe 134/1/g, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve, që janë shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 5 (13-2012-118), datë 11.1.2012, ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit Armand Llakaj për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendimin, të kryer në bashkëpunim, dhe në bazë të neneve 78/1 dhe 25, të Kodit Penal (KP) dënimin e tij me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Armand Llakaj për kryerjen e veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe në bazë të nenit 278/2 të KP-së dënimin e tij me 2 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP-së dënimin e tij përfundimisht me 25 vjet burgim. Gjithashtu kjo gjykatë ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit Marjus Tafa për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendimin, të kryer në bashkëpunim, dhe në bazë të neneve 78/1 dhe 25 të Kodit Penal (KP) dënimin e tij me 23 vjet burgim.

2. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2012-1142 (410), datë 11.7.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 5 (13-2012-118), datë 11.1.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.



3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-500, datë 3.4.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga i gjykuari Armand Llakaj, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

II

4. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese, duke pretenduar se u është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

4.1 Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit, pasi në vendim nuk shprehet për rekursin e kërkuesit Marjus Tafa.

4.2 Është cenuar parimi i barazisë së armëve, sepse gjykatat e faktit nuk kanë administruar provat e kërkuara nga mbrojtja e kërkuesve.

4.3 Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, sepse gjykatat e faktit në vendimet e tyre janë bazuar në hamendësime.

5. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar me shkrim në mënyrë të përmbledhur se:

5.1 Rekursi është ushtruar nga të dy kërkuesit në një dokument të përbashkët, gjë që ka krijuar vështirësi në individualizimin e kërkesave të secilit kërkues, duke sjellë konfuzion në shqyrtimin e tij nga Gjykata e Lartë. Gjithsesi, në kushtet kur nuk ka një vendim mbi rekursin e kërkuesit Marjus Tafa, ky i fundit nuk ka shteruar mjetet për mbrojtjen e të drejtave të tij, si kusht për t'iu drejtuar juridiksionit kushtetues. Gjykata duhet ta orientojë atë t'i drejtohet Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e kërkesës së tij, të ometuar nga ajo gjykatë edhe për faj të tij.

5.2 Argumentet e kërkuesve për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve kanë të bëjnë me çmuarjen e provave nga ana e gjykatës për të krijuar bindjen e saj në lidhje me fajësinë apo pafajësinë dhe si të tilla nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues. Referuar materialeve të dosjes gjyqësore rezulton se gjykatat e faktit kanë marrë provat e kërkuara nga përfaqësuesit e secilit prej dy të pandehurve. Kërkuesit nuk përcaktojnë se cilat janë provat e kërkuara nga mbrojtja që nuk janë administruar në gjykim, si dhe mbi cilat prova të akuzës nuk u është dhënë mundësia për të debatuar.

5.3 Pretendimi i kërkuesve se është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë duhet të trajtohet në këndvështrim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

6. Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

7. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkeljen e së drejtës themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton se kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individ mund t'i drejtohet asaj vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, se në kushtet kur nuk ka një vendim mbi rekursin e kërkuesit Marjus Tafa, ky i fundit nuk i ka shteruar mjetet për mbrojtjen e të drejtave të tij, si kusht për t'iu drejtuar juridiksionit kushtetues, është i pabazuar. Nga materialet e kësaj çështjeje, siç do të arsyetohet



në vijim në vendim, rezulton se kërkuesi Marjus Tafa ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, ku ka ngritur edhe pretendimet e tij lidhur me procesin penal të zhvilluar në gjykatat e faktit, duke shteruar mundësitë procedurale të ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Fakti nëse Gjykata e Lartë ka marrë apo jo në shqyrtim këto pretendime, nuk do të thotë se kërkuesi nuk ka përdorur mjetet ligjore në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet t'i drejtohet asaj në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

9. Për pasojë, pretendimet e kërkuesve janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

10. Kërkuesi Marjus Tafa pretendon se Gjykata e Lartë nuk ka respektuar standardin e arsyetimit të vendimit, pasi në vendim nuk shprehet për rekursin e tij. Ndërsa subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, lidhur me këtë pretendim ka prapësuar se rekursi është ushtruar nga të dy kërkuesit në një dokument të përbashkët, gjë që ka krijuar vështirësi në individualizimin e kërkesave të secilit kërkues, duke sjellë konfuzion në shqyrtimin e tij nga Gjykata e Lartë.

11. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe

mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se kundër vendimit nr. 10-2012-1142 (410), datë 11.7.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës kanë



ushtruar rekurs të dy kërkuesit, Armand Llakaj dhe Marjus Tafa, brenda afatit ligjor 30-ditor të parashikuar në nenin 435/1 të KPP-së. Në vendimin e Gjykatës së Lartë, si në pjesën ku parashtrohen shkaqet e rekursit (*shih f. nr. 2 të vendimit*), ashtu edhe në pjesën ku Gjykata shprehet nëse rekursi përmban apo jo shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së (*shih f. nr. 3 të vendimit*), si dhe në dispozitivin e tij gjejnë pasqyrim vetëm pretendimet e ngritura në rekurs nga kërkuesi Armand Llakaj. Fakti që edhe kërkuesi tjetër (Marjus Tafa) ka ushtruar rekurs, si dhe nëse shkaqet e paraqitura prej tij janë shqyrtuar apo jo nga Gjykata e Lartë, nuk gjejnë pasqyrim në vendimin e kësaj të fundit.

16. Bazuar në standardet kushtetuese të lartpërmendura, Gjykata vlerëson se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs nga kërkuesi Marjus Tafa, si dhe fakti që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk shprehet në vendim mbi rekursin e tij, krijojnë dyshime të arsyeshme nëse ky Kolegj ka arritur të marrë ose jo në shqyrtim dhe të vlerësojë shkaqet e pretenduara prej kërkuesit, çka përbën një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës.

17. Nga ana tjetër, Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimin nr. 27 datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata çmon se Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke mos e arsyetuar vendimin për rekursin e kërkuesit, i ka mohuar atij edhe të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të drejtën për të pasur një vendim përfundimtar që do t'u jepte përgjigje pretendimeve të tij. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për

të vënë në lëvizje gjykatën për çështjet civile, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'u drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në kuptim të sa më sipër, duke konsideruar se e drejta e aksesit në gjykatë nuk mund t'i cenohet kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtaritë e vetë organeve shtetërore, gjykatës në rastin konkret (*shih vendimin nr. 32, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata vlerëson se i takon Gjykatës së Lartë të marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekursin e paraqitur nga kërkuesi Marjus Tafa.

19. Në këto kushte, bazuar në rëndësinë e garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në proceset penale në të cilat është vendosur burgimi i individit, që passjell sakrificimin maksimal të lirisë personale të tij, kjo e fundit e mbrojtur si vlerë themelore nga Kushtetuta, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë, në pjesën ku nuk shprehet për rekursin e paraqitur nga kërkuesi Marjus Tafa, ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit, si dhe të drejtën e aksesit në gjykatë të tij.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve

20. Kërkuesit pretendojnë se gjykatat e faktit nuk kanë administruar provat e kërkuara nga mbrojtja e tyre, si dhe nuk kanë arsyetuar mospranimin e tyre. Sipas kërkuesve, nga analiza e dosjes gjyqësore vihet re se në të gjitha shkallët e gjykimit mbrojtësit e kërkuesve nuk i është dhënë mundësia për të dëgjuar dhe debatuar të gjitha provat e paraqitura nga akuza.

21. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se argumentet e kërkuesve për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve kanë të bëjnë me çmuarjen e provave nga ana e gjykatës për të krijuar bindjen e saj në lidhje me fajësinë apo pafajësinë dhe si të tilla nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

22. Në lidhje me paraqitjen dhe administrimin e provave në gjykim, në kuptim të parimit të barazisë së armëve, Gjykata ka mbajtur



qëndrimin se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër (*shih vendimet nr. 19, datë 18.9.2008; nr. 7, datë 27.4.2005; nr. 16, datë 27.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se marrja dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave, interpretimi i ligjit material dhe procedural, si dhe aplikimi i tij në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Për sa i përket mënyrës se si janë interpretuar dhe vlerësuar provat nga gjykatat e zakonshme, kjo çështje nuk përbën objekt kontrolli për këtë Gjykatë, sepse ajo mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, por jo për mënyrën e vlerësimit të tyre. Gjykata ndërhyt vetëm në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Pra, si rregull, është kompetencë e gjykatave të zakonshme të vlerësojnë provat e paraqitura (administruara) në gjykim, ndërsa Gjykatës i takon të vlerësojë nëse procedurat, në tërësinë e tyre, kanë qenë të drejta, që në rastin e proceseve penale ky vlerësim përfshin edhe respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

23. Nisur nga fakti se Gjykata e Lartë nuk është shprehur për rekursin e ushtruar nga kërkuesi Marjus Tafa, Gjykata vlerëson se ky pretendim duhet shqyrtuar vetëm për kërkuesin Armand Llakaj. Lidhur me këtë të fundit Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim në vendimin e Gjykatës së Apelit është arsyetuar mbi shkaqet e ankimit, si dhe lidhur me paraqitjen dhe administrimin e provave në gjykim. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkuesi edhe pse pretendon cenimin e parimit të barazisë së armëve, nuk përcakton se cilat janë provat e kërkuara nga mbrojtja, të cilat nuk janë administruar në gjykim, si dhe mbi cilat prova të akuzës kërkuesit nuk i është dhënë mundësia për të debatuar. Për pasojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar.

D. Për pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë

24. Kërkuesit pretendojnë se u është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, sepse gjykatat e

faktit në vendimet e tyre janë bazuar në hamendësime, si dhe në prova të marra në mënyrë të paligjshme. Ndërsa subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se ky pretendim i kërkuesve duhet të trajtohet në këndvështrim të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

25. Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilëve është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet e një gjykimi të drejtë, i kërkuar nga neni 6/1 i Konventës. Ky parim ndalon shprehjen e parakohshme nga vetë gjykata të vlerësimit se personi “i akuzuar për një vepër penale” është fajtor përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin. (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 12 korrik 2013; Karaman kundër Gjermanisë, datë 27 shkurt 2014*). Në çështjen Karaman kundër Gjermanisë, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se gjykatat penale janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur, dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime.

27. Në rastin në shqyrtim, lidhur vetëm me kërkuesin Armand Llakaj (*shih më lart paragrafin nr. 24*), Gjykata vëren se gjykatat vendimet e tyre i kanë bazuar në një sërë provash, të tilla si aktet e ekspertimit, thëniet e dëshmitarëve, rezultatet e përgjimit ambiental etj. Edhe pse akti i ekspertimit biologjik nr. 5983, datë 7.8.2009 përmban disa hamendësime, nuk rezulton që gjykata të ketë nisur procesin me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të



cilën akuzohet. Gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të tij, gjykata nuk ka arritur asnjë konkluzion *apriori* për fajësinë e kërkuesit, duke u bazuar vetëm në aktin e ekspertimit biologjik. Këtyj të fundit nuk i është dhënë një vlerë e paracaktuar në gjykim, por ai i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor së bashku me provat e tjera të administruara në proces, duke u vlerësuar në unitet me to. Për rrjedhojë, Gjkata çmon se edhe ky pretendim i kërkuesit nuk është i bazuar.

28. Në përfundim, Gjkata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë, në pjesën ku nuk shprehet për rekursin e paraqitur nga kërkuesi Marjus Tafa, ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit, si dhe të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, prandaj pretendimi i këtij kërkuesi është i bazuar dhe duhet pranuar. Ndërsa pretendimet e kërkuesit Armand Llakaj janë haptazi të pabazuara dhe duhen rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjkata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës për kërkuesin Marjus Tafa.

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-500, datë 3.4.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në pjesën ku nuk shprehet për rekursin e paraqitur nga kërkuesi Marjus Tafa.

- Rrëzimin e kërkesës për kërkuesin Armand Llakaj.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 69, datë 14.11.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjkata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedjakryetar	i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	anëtare	e	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“ “
Gani Dizdari	anëtar	i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar	i	“ “
Fatos Lulo	anëtar	i	“ “
Vladimir Kristo	anëtar	i	“ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 7.7.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 38 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Majlinda Salillari

SUBJEKT I INTERESUAR: Avokatura e Përgjithshme e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2016-796 (183), datë 24.3.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 124, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27–28, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja ka punuar pranë subjektit të interesuar, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, si avokate shteti pranë Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale e më pas edhe pranë Ministrisë së Inovacionit, Teknologjisë Informative dhe Komunikimit deri në datën 4.4.2011. Me urdhrin



12, datë 4.4.2011 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është urdhëruar zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënies së punës pasi nuk plotësohej kriteri ligjor i parashikuar në nenin 20/c, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, sepse kërkesja ishte shkarkuar nga detyra e gjyqtarës dhe nuk kishte kaluar me sukses procesin përzgjedhës kualifikues.

2. Në këto kushte, kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesëpadi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, ta dëmshpërblejë me pagën e 14 muajve, për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 1721 (3430), datë 28.6.2011, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e subjektit të interesuar, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, të dëmshpërblejë kërkesen me pagën e 10 muajve për zgjidhje të kontratës së punës për shkaqe të paarsyeshme.

4. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 380 (10-2013-771), datë 13.5.2013.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi mbi rekursin e subjektit të interesuar, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1721 (3430), datë 28.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe të vendimit nr. 380 (10-2013-771), datë 13.5.2013, të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

II

6. **Kërkesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”) për shfuqizimin e vendimit objekt kërkesë me pretendimin se:

6.1 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse ka bërë një interpretim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit.

6.2 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka mbështetur vendimin në nenin 34 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, i cili ka regjim kalimtar.

6.3 Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë bie ndesh me Kodin e Punës dhe vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë.

6.4 Arsyetimi i vendimit të Kolegjit

Administrativ të Gjykatës së Lartë është kontradiktor, duke cenuar në këtë mënyrë standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

6.5 Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë.

7. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, ka prapësuar me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

7.1 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vlerësuar se vendimet e gjykatave janë të pabazuara në ligj dhe se shkaqet në rekurs janë nga ato që parashikohen në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Ai nuk ka administruar asnjë provë të re, si dhe nuk ka bërë një rivlerësim të provave të administruara në gjykimet e faktit.

7.2 Vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë alogjik, të ketë kundërbërje, si dhe ka respektuar të gjitha elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

7.3 Kërkesja nuk ka arritur ta ngrejë në nivel kushtetues pretendimin e saj për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka garantuar procesin e rregullt ndaj kërkeses.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

8. Gjykata çmon se kërkesja legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte, çka nënkupton se kërkuksi duhet t'i shfrytëzojë, në



shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin në shqyrtim, Gjykata çmon se kërkuesja nuk ka në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimin objekt shqyrtimi, prandaj ajo legjitimohet t'i drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses *prima facie* bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për pasojë ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

11. Kërkuesja pretendon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka bërë një interpretim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj. Po mbi të njëjtën rrethanë kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë. Gjykata në jurisprudencën e saj vlerësimin e provave nga ana e Gjykatës së Lartë e ka trajtuar vetëm nën këndvështrimin e respektimit apo jo të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, prandaj Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkueses do të analizohet nën dritën e këtij parimi.

12. Gjykata ka theksuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Lidhur me vlerësimin e provave nga Gjykata e Lartë, Gjykata ka arritur në përfundimin se Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtëm të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta (*shih vendimin nr. 11, datë*

3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata e Lartë jo vetëm nuk ka kompetencë të administrojë prova të reja, por, gjithashtu, nuk mund të vlerësojë ndryshe provat e vlerësuara nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të anashkalojë ekzistencën e fakteve dhe të rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin e faktit apo t'i ndryshojë ato (*shih vendimet nr. 53, datë 20.7.2015; nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë a priori nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit. Nëse Kolegji i Gjykatës së Lartë ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga gjykatat e faktit, atëherë ai duhet t'i prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë çështjen për rigjykim (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Nga ana tjetër, lidhur me shqyrtimin e çështjeve administrative nga Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, Gjykata ka theksuar se kjo nuk do të thotë se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve apo prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën (*shih vendimin nr. 29, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata është shprehur se Gjykata e Lartë ka detyrimin jo vetëm të njoftojë rregullisht palët për procesin, por edhe t'u sigurojë atyre mundësinë që të marrin pjesë në proces dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve. Gjykata e Lartë duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato apo të paraqesin argumentet e tyre për çështjen (*shih vendimin nr. 29, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështjen në shqyrtim Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nisur nga përmbajtja e urdhrit nr. 12, datë 4.4.2011 të



Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për largimin nga detyra të kërkuases, ka konstatuar se shkaqet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të saj rezultojnë se janë shkarkimi nga detyra e gjyqtarës, si dhe moskalimi me sukses i procesit përzgjedhës kualifikues. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi ka analizuar provat e administruara në gjykim, ka arsyetuar se asnjëri prej shkaqeve të lartpërmendura nuk justifikojnë zgjidhjen me efekt të menjëhershëm të kontratës së punës. Konkretisht, lidhur me testimin e avokatëve të shtetit ka arritur në përfundimin se kërkuësja nuk ka marrë pjesë në fazën e dytë të procesit të konkurrimit të zhvilluar për t'u emëruar si avokat shteti, pasi nuk ka pasur dijeni për të (*shih faqen nr. 3 të vendimit të shkallës së parë*). Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me të njëjtin arsyetim.

16. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1721 (3430), datë 28.6.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe të vendimit nr. 380 (10-2013-771), datë 13.5.2013 të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Në ndryshim nga gjykatat e faktit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se kërkuësja nuk ka marrë pjesë në fazën e dytë të procesit përzgjedhës kualifikues dhe për këtë arsye ajo nuk i ka kaluar fazat e konkurrimit, duke mos i plotësuar kriteret ligjore për t'u emëruar si avokate shteti (*shih faqet nr. 3–4 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

17. Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ për të arritur në përfundimin si më lart, i cili është i ndryshëm nga ai i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Apelit Durrës, ka bërë një rivlerësim të provave të administruara e të vlerësuara nga gjykatat e faktit. Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë edhe pse arsyeton se kërkuësja nuk ka marrë pjesë në fazën e dytë të procesit të kualifikimit, nuk është shprehur për dijeninë apo jo të saj për këtë fazë, edhe pse është pikërisht kjo rrethanë tek e cila gjykatat e faktit mbështesin vlerësimin e tyre. Gjykata e Lartë, pavarësisht se nuk e ka vënë në dyshim vlerën e provave të paraqitura, ka bërë një vlerësim të ndryshëm të tyre, duke ndryshuar në themel vendimet e gjykatave më të ulëta.

18. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e

subjektit të interesuar, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, dhe se procesi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në datën 24.3.2016, rreth 5 vjet nga dhënia e vendimit të formës së prerë nga ana e Gjykatës së Apelit Durrës. Bazuar në standardet e lartpërmendura, Gjykata çmon se edhe pse sekretaria gjyqësore i ka përmbushur kriteret e caktuara nga ligji për njoftimin e palëve me shpallje, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se e ka zgjidhur çështjen në themel, duke bërë një vlerësim të provave, ka vendosur vetëm mbi bazën e pretendimeve të subjektit të interesuar, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, të parashtruara në rekurs, duke mos i dhënë mundësinë kërkuases që të paraqiste pretendimet e saj në lidhje me çështjen.

19. Në këto kushte, Gjykata çmon se nëse Gjykata e Lartë do të kishte dyshime mbi dijeninë e kërkuases për fazën e dytë të konkurrimit në testimin e organizuar për avokatët e shtetit jo vetëm duhet të administronte edhe prapësimet e kërkuases, por duhet ta kthente çështjen për rishqyrtim në gjykatat e faktit, me udhëzimet përkatëse, në mënyrë që ato të arrinin në një konkluzion duke ia nënshtuar provat hetimit të plotë gjyqësor. Për pasojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj⁵, por edhe të drejtën e kërkuases për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në gjykim.

C. Për pretendimin për zbatimin e gabuar të ligjit material

20. Kërkuësja pretendon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka mbështetur vendimin në nenin 34, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, i cili ka regjim kalimtar dhe se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë bie ndesh me Kodin e Punës dhe vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë.

21. Gjykata ka pranuar në mënyrë të vazhdueshme në jurisprudencën e saj se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është, si rregull, atribut i gjykatave

⁵ Gjyqtarët V. Kristo dhe G. Dizdari votuan për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj edhe për shkak se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka atribuuar vetes kompetenca të paautorizuara nga ligjvënësi sipas qëndrimit të shprehur në mendimin paralel të vendimit nr. 35, datë 27.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese.



të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i Gjykatës nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Referuar natyrës ligjore të këtij pretendimi, Gjykata vlerëson se çështja e pretenduar nga kërkuuesja ka të bëjë me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit material, e cila, përderisa nuk lidhet me cenimin e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, i takon juridiksionit të zakonshëm dhe jo kategorisë së çështjeve që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Ç. Për pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

23. Kërkuuesja pretendon gjithashtu se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi është mbështetur në një arsyetim kontradiktor.

24. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 18, datë 15.3.2016; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet

që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka përmbushur standardet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese lidhur me parimin e arsytimit të vendimit. Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs dhe u ka dhënë përgjigje në themel pretendimeve të kërkueses. Për më tepër, sikurse u përmend më lart, këto pretendime të kërkueses nuk lidhen me cenimin e të drejtave të saj kushtetuese, por me mënyrën e vlerësimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes, të cilat sipas jurisprudencës së Gjykatës nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata çmon se edhe ky pretendim i kërkueses është haptazi i pabazuar.

27. Si përfundim, Gjykata çmon se në rastin konkret Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, si dhe të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në gjykim, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkueses është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2016-796 (183), datë 24.3.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.



- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar),
Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari,
Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj
Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuese Majlinda Salillari jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2016-796 (183), datë 24.3.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

2. Kërkesja ka pretenduar para Gjykatës cenimin e standardit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, për arsye se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka bërë një interpretim të ndryshëm të provave dhe fakteve që janë administruar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit.

3. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkesja i është drejtuar gjykatës me padi me objekt shpërblimin me 12 paga mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e pa shkaqe të justifikuara të marrëdhënieve të punës, si dhe rikthimin në vendin e mëparshëm. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi ka arsyetuar se shkaqet që rezultojnë nga urdhri i Avokatit të Përgjithshëm i Shtetit nuk justifikojnë zgjidhjen me efekt të menjëhershëm të kontratës së punës, ka vendosur të pranojë pjesërisht padinë, duke vendosur detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen me 10 paga mujore. Sipas kësaj gjykate, kërkesja nuk ka marrë pjesë në fazën e dytë të procesit të konkurrimit të zhvilluar për t'u emëruar si avokat shteti, pasi nuk ka pasur dijeni për të. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1721 (3430), datë 28.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe të

vendimit nr. 380 (10-2013-771), datë 13.5.2013, të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Në ndryshim nga gjykatat e faktit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se kërkesja nuk ka marrë pjesë në fazën e dytë të procesit përzgjedhës kualifikues dhe për këtë arsye ajo nuk i ka kaluar fazat e konkurrimit, duke mos i plotësuar kriteret ligjore për t'u emëruar si avokate shteti.

5. Sipas shumicës “Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë edhe pse arsyeton se kërkesja nuk ka marrë pjesë në fazën e dytë të procesit të kualifikimit, nuk është shprehur për dijeninë apo jo të saj për këtë fazë, edhe pse është pikërisht kjo rrethanë tek e cila gjykatat e faktit mbështesin vlerësimin e tyre. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e subjektit të interesuar, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, dhe se procesi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në datën 24.3.2016, rreth 5 vjet nga dhënia e vendimit të formës së prerë nga ana e Gjykatës së Apelit Durrës. Bazuar në standardet e lartpërmendura, Gjykata çmon se edhe pse sekretaria gjyqësore i ka përmbushur kriteret e caktuara nga ligji për njoftimin e palëve me shpallje, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se e ka zgjidhur çështjen në themel, duke bërë një vlerësim të provave, ka vendosur vetëm mbi bazën e pretendimeve të subjektit të interesuar, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, të parashtruara në rekurs, duke mos i dhënë mundësinë kërkueses që të paraqiste pretendimet e saj në lidhje me çështjen. Në këto kushte, Gjykata çmon se nëse Gjykata e Lartë do të kishte dyshime mbi dijeninë e kërkueses për fazën e dytë të konkurrimit në testimin e organizuar për avokatët e shtetit jo vetëm duhet të administronte edhe prapësimet e kërkueses, por duhet ta kthente çështjen për rishqyrtim në gjykatat e faktit, me udhëzimet përkatëse, në mënyrë që ato të arrinin në një konkluzion duke ia nënshtruar provat hetimit të plotë gjyqësor.” (shih paragrafët 17-19 të vendimit).

6. Në ndryshim nga sa arsyeton shumica, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj ligjore dhe ka respektuar standardin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Ky parim, si një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, karakterizohet, në sensin material, nga funksioni gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje



që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, i sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Sipas ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

vendimet e shpallura nga gjykata administrative e apelit dhe gjykata administrative e shkallës së parë mund të ankimohen me rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë vetëm kur: a) ligji material nuk është respektuar, është interpretuar ose zbatuar keq apo vendimi i dhënë është në kundërshtim me një vendim të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ose të kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë; b) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit; c) ka shkelje të rënda procedurale, të cilat kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit (neni 58). Sipas nenit 61 të këtij ligji, shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, kurse sipas nenit 63/d të ligjit ky Kolegj, pasi shqyrton çështjen në dhomë këshillimi ose seancë gjyqësore, vendos, mes të tjerash, ndryshimin e vendimeve të shkallës së parë dhe të apelit.

9. Në rastin në shqyrtim, bazuar në standardet e mësipërme, si dhe në vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, rezulton se vlerësimi i kësaj gjykate është përqendruar vetëm në respektimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta, pra në mënyrën e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, konkretisht neni 21/3 i këtij ligji, i cili përcakton rregullat dhe mënyrën për t'u emëruar si avokat i shtetit. Në kuptim të përmbajtjes së kësaj dispozite, Gjykata e Lartë ka interpretuar edhe aktet dhe provat e administruara nga gjykatat e faktit, duke vlerësuar se për sa kohë që paditësja nuk ka kaluar fazat e konkurrimit sipas ligjit, nuk ndodhemi përpara ndërprerjes së menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara të marrëdhënies së punës.

10. Në ndryshim nga sa arsyeton shumica, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka respektuar kufijtë e shqyrtimit të çështjes që i njihen atij, duke analizuar dhe vlerësuar faktet dhe provat e administruara në gjykim në këndvështrim të respektimit të dispozitave ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete në shqyrtim. Gjykata e Lartë nuk ka anashkaluar prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit dhe nuk ka pranuar në gjykim prova të reja që nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt. Pasi ka marrë në shqyrtim



provat e administruara në gjykim, Kolegji Administrativ ka konkluduar se gjykatat e faktit kanë bërë një interpretim të gabuar të ligjit dhe se shkaqet e ngritura në rekurs janë nga ato që parashikohen në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012.

11. Për sa më sipër, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se pretendimi i kërkuar për cenimin e standardit të gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar, për rrjedhojë Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtarë: Fatos Lulo, Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 121, datë 9.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 4, pika 46 dhe të nenit 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 5/1

Përjashtimet

1. Kërkesat e kësaj rregulloreje, përveç sa parashikohet në këtë nen, nuk do të zbatohen për subjektet apo personat që ofrojnë shërbimet e pagesave nëpërmjet telefonisë celulare ose pajisjeve të tjera elektronike, vetëm për blerjen e biletave elektronike (përfshirë transportin, lojërat, parkimin ose hyrjen në evente, por duke përjashtuar produktet fizike), vetëm në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) vlera e një transaksioni pagese nuk tejkalon shumën prej 1,000 (një mijë) lekësh;

b) vlera në total e transaksioneve, për çdo klient, nuk tejkalon shumën prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekësh në muaj; si dhe

c) vlera e parapaguar në total për transaksionet e çdo klienti, në rastin e llogarive me parapagim, nuk tejkalon shumën prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekësh në muaj.

2. Subjektet apo personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, njoftojnë Bankën e Shqipërisë:

a) për veprimtarinë dhe llojet e transaksioneve që kryejnë, duke paraqitur, së bashku me njoftimin, edhe ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit; si dhe

b) në çdo rast kur tejkalojnë kufijtë e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Subjektet apo personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, paraqesin çdo informacion dhe dokumentacion shtesë që kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

4. Banka e Shqipërisë mund të kryejë verifikimin në vend në këto subjekte apo persona, mbi plotësimin e kërkesave të këtij neni.”

b) Përmbajtja e pikës 4, të nenit 6, ndryshon si më poshtë vijon:

“Kapitali fillestar minimal i kërkuar për institucionet e parasë elektronike është 50 (pesëdhjetë) milionë lekë.”

c) Pas pikës 2, të nenit 32, shtohet pika 3 me përmbajtje si vijon:

“Institucionet e parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë, marrin masa për plotësimin e kapitalit fillestar minimal të përcaktuar në pikën 4, të nenit 6, të kësaj rregulloreje, brenda datës 31 dhjetor 2017”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko

**VENDIM****Nr. 122, datë 9.11.2016****PËR NJË NDRYSHIM NË
RREGULLOREN “PËR
INSTRUMENTET E PAGESAVE
ELEKTRONIKE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b; nenit 21 dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe të nenit 4, pika 47, nenit 126 dhe nenit 129, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit të Sistemeve të Pagesave dhe Kontabilitetit e Financës,

VENDOSI:

1. Pika 5 e nenit 27 të rregullores “Për instrumentet e pagesave elektronike”, miratuar me vendimin nr. 11, datë 6.2.2008, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të ndryshohet si më poshtë:

“Kufijtë minimalë dhe maksimalë, brenda të cilëve emetohet paraja elektronike, përcaktohen në kontratën e emetimit të parësë elektronike, të parashikuar në pikën 4 të këtij neni.”

2. Ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe Kontabilitetit e Financës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Gent Sejko**

VENDIM**Nr. 123, datë 9.11.2016****PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PARAPRAK PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARISË SHITESË NGA BANKA
SOCIETE GENERALE ALBANIA SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të nenit 18, pika 8, të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka Societe Generale Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shitesë të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, duke vepruar si agjent në sigurime.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Societe Generale Albania sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gent Sejko**

**KËRKESË****Nr. 5445, datë 9.11.2016****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga projekti “Rrugët zëvendësuese M03 për ndërtimin e hidrocentralit të Moglicës”, për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “kullotë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe

personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “kullotë”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 7 048 907 (shtatë milionë e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e shtatë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS**

Bahri Shaqiri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA PROJEKTI
"RRUGËT ZËVENDËSUESE M03 PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TE MOGLICËS"

Nr	Emri i pronarit	Zona Kadastr.	Numri Paturise	Lloji i pasurise	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (leke)	Shenime
	Fshati Nikollare, Bashkia Maliq							
1	SHTET	2799	406/2	KULLOTE	1615	83	134045	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
2	RAMAZAN BESIM VELIASI	2799	413/4	ARE	109	100	10900	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
3	ARUN RRAPO XHEMOLLARI	2799	425/8	ARE	58	100	5800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
4	FERIT RAIF HOXHALLARI	2799	510/2	ARE	277	100	27700	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
5	SHTET	2799	506/1	ARE	244	100	24400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
6	SHTET	2799	502	ARE	980	100	98000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
7	SHTET	2799	505/2	ARE	365	100	36500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
8	SHTET	2799	508	KULLOTE	188	83	15604	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
9	SELIM ENVER BEQIRAJ	2799	593/4	ARE	306	100	30600	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
10	SHTET	2799	629	ARE	209	100	20900	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
11	SHTET	2799	628	ARE	234	100	23400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
12	SULO OSMAN SHKEMBI	2799	625/2	ARE	939	100	93900	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
13	MITAT ISMAIL HOXHALLARI	2799	616/1	ARE+TRUALL	610	100	61000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
14	TOSUN MITAT HOXHALLARI	2799	617/1	ARE+TRUALL	402	100	40200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
15	SHTET	2799	618	ARE	52	100	5200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
16	XHEMIL ENVER BEQIRAJ	2799	619	ARE+TRUALL	331	100	33100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
17	SHTET	2799	617/2	ARE	523	100	52300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
18	FUAT AVNI BEQIRAJ	2799	622	ARE	753	100	75300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP



19	SHTET	2799	621	ARE	152	100	15200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
20	SHTET	2799	620	ARE	465	100	46500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
21	SHTET	2799	423	ARE	528	100	52800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
22	SHTET	2799	422	ARE	125	100	12500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
23	PERPARIM LATIF SHKEMBI	2799	425/2	ARE	168	100	16800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
24	VEZIRE EKUR VELIASI	2799	413/8	ARE	283	100	28300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
25	LIVAN NYSTRET HOXHA	2799	510/3	ARE	239	100	23900	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
26	SULO OSMAN SHKEMBI	2799	509/1	ARE	167	100	16700	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
27	ALI BESIM VELIASI	2799	413/2	ARE	144	100	14400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
28	TOSUN MITAT HOXHALLARI	2799	413/3	ARE	125	100	12500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
29	LIVAN NYSTRET HOXHA	2799	413/5	ARE	92	100	9200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
30	SANI MITAT HOXHALLARI	2799	413/6	ARE	131	100	13100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
31	ENVER MEHMET BEQIRAJ	2799	413/7	ARE	137	100	13700	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
32	SEFEDIN ABAS VELIASI	2799	413/9	ARE	205	100	20500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
33	SULO OSMAN SHKEMBI	2799	413/10	ARE	211	100	21100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
34	SHTET	2799	425/1	ARE	138	100	13800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
35	FERIT RAIF HOXHALLARI	2799	425/4	ARE	74	100	7400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
36	SEFEDIN ABAS VELIASI	2799	505/1	ARE	105	100	10500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
37	SHTET	2799	506/2	KULLOTE	1288	83	106904	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
38	EKURAN NELKE VELIASI	2799	425/3	ARE	85	100	8500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
39	XHEMIL ENVER BEQIRAJ	2799	425/5	ARE	63	100	6300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
40	SELIM ENVER BEQIRAJ	2799	425/6	ARE	57	100	5700	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
41	VAIT BARJAM HOXHALLARI	2799	425/7	ARE	60	100	6000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
42	MITAT ISMAIL HOXHALLARI	2799	425/9	ARE	75	100	7500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
43	TAKUSH NEVRUS VELIASI	2799	425/10	ARE	97	100	9700	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
44	SALI SULO SHKEMBI	2799	425/11	ARE	35	100	3500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
45	BEHAR BEJO HOXHA	2799	425/12	ARE	26	100	2600	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
46	DULE RRAPO XHEMOLLARI	2799	425/13	ARE	51	100	5100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
47	SHTET	2799	425/14	ARE	32	100	3200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
48	PERPARIM LATIF SHKEMBI	2799	625/3	ARE	111	100	11100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
49	SANI MITAT HOXHALLARI	2799	616/2	ARE+TRUALL	509	100	50900	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
50	SHTET	2799	616/3	ARE	93	100	9300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
51	SHTET	2799	616/4	ARE	88	100	8800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
57	SANIE BEQIRAJ	2799	617/3	ARE	1028	100	102800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP



58	SELM ENVER BEQIRAJ	2799	617/4	ARE+TRUALL	269	100	26900	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
60	SHTET	2799	617/6	TRUALL	300	198	59400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
61	SHTET	2799	625/4	ARE	214	100	21400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
62	VAIT BARJAM HOXHALLARI	2799	610/2	ARE+TRUALL	933	100	93300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
63	SHTET	2799	610/8	ARE	1352	100	135200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
64	SHTET	2799	610/11	KULLOTE	247	83	20501	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
65	SHTET	2799	610/13	ARE	1493	100	149300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
67	SHTET	2799	610/14	ARE	318	100	31800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
68	I PAKONFIRMUAR	2799	413/1	ARE	76	100	7600	I PAKONFIRMUAR
69	I PAKONFIRMUAR	2799	414/3	ARE	245	100	24500	I PAKONFIRMUAR
	Fshati Gurshqipe, Bashkia Maliq							
70	SELAM BESIM HOXHA	1911	349	ARE	661	100	66100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
71	TELO BILAL LLAZI	1911	351/2	ARE	358	100	35800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
72	SHTET	1911	72/8	ARE	129	100	12900	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
73	SHTET	1911	73/1	KULLOTE	903	83	74949	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
74	SHTET	1911	350	ARE	213	100	21300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
75	SHTET	1911	352	KULLOTE	514	83	42662	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
76	SHTET	1911	220/1	ARE	826	100	82600	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
77	SHTET	1911	257/1	TRUALL	228	198	45144	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
78	SHTET	1911	204	KULLOTE	213	83	17679	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
79	IZET RIZA MATRAKU	1911	199/12	ARE	211	100	21100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
80	SHEFKI SHEME HOXHA	1911	69/8	ARE	653	100	65300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
81	SHTET	1911	72/1	ARE	1020	100	102000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
82	AGIM BILAL LLAZI	1911	171/29	ARE	235	100	23500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
83	SAMIT SADIK MATRAKU	1911	202/9	ARE	156	100	15600	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
84	SAMIT SADIK MATRAKU	1911	202/5	ARE	90	100	9000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
85	ASLLAN RAMAN MATRAKU	1911	220/2	ARE	654	100	65400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
86	NAIM KAJO GAXHENJI	1911	227/1	ARE	110	100	11000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
87	SHTET	1911	49/21	ARE	147	100	14700	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
88	SHEQERE XHEMAL MATRAKU	1911	49/22	ARE	234	100	23400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
89	SHENDET ZENI MATRAKU	1911	49/23	ARE	237	100	23700	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
90	SHTET	1911	68/14	ARE	36	100	3600	KONFIRMUAR NGA ZVRPP



91	SHTET	1911	68/15	ARE	332	100	33200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
92	SELAM BESIM HOXHA	1911	69/2	ARE	492	100	49200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
93	BUJAR LAYER MATRAKU	1911	69/4	ARE	448	100	44800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
94	FERIT QAZIM MATRAKU	1911	69/5	ARE	625	100	62500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
95	QAZIM FEJM MATRAKU	1911	69/6	ARE	478	100	47800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
96	SHEFKI SHEME HOXHA	1911	69/7	ARE	525	100	52500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
97	SHTET	1911	69/10	ARE	785	100	78500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
98	LIMAN MECAN MATRAKU	1911	69/11	ARE	350	100	35000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
99	SHTET	1911	69/12	ARE	945	100	94500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
100	SHTET	1911	72/9	ARE	451	100	45100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
101	SHTET	1911	72/10	ARE	194	100	19400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
102	AGIM BILAL LLAZI	1911	72/16	ARE	92	100	9200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
103	KADRI MEHMETALI MATRAKU	1911	72/15	ARE	375	100	37500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
104	MEDI SHEME HOXHA	1911	72/19	ARE	38	100	3800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
105	SHTET	1911	72/20	ARE	132	100	13200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
106	SHTET	1911	72/21	ARE	394	100	39400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
107	SHTET	1911	72/22	ARE	641	100	64100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
108	SHTET	1911	72/24	ARE	38	100	3800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
109	SHTET	1911	171/40	KULLOTE	72	83	5976	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
110	SHTET	1911	171/39	ARE	343	100	34300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
111	DEPRIM MEHMETALI MATRAKU	1911	171/44	ARE	169	100	16900	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
112	RIZA QEMAL HOXHA	1911	171/45	ARE	106	100	10600	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
113	KADRI MEHMETALI MATRAKU	1911	171/46	ARE	351	100	35100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
114	SHTET	1911	171/43	ARE	1025	100	102500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
115	SHTET	1911	171/28	ARE	1055	100	105500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
116	BAKI SHEME HOXHA	1911	203/1	ARE	324	100	32400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
117	SHTET	1911	154	KULLOTE	316	83	26228	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
118	SHTET	1911	151	ARE	382	100	38200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
119	SHTET	1911	150	ARE	184	100	18400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
120	SHTET	1911	132/1	ARE	668	100	66800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
121	SHTET	1911	127/18	ARE	2781	100	278100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
122	FAIK TAIP XHAVERI	1911	127/12	ARE	410	100	41000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
123	KUTIM FAIK XHAVERI	1911	127/14	ARE	791	100	79100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
124	XHAVER FAIK XHAVERI	1911	127/15	ARE	229	100	22900	KONFIRMUAR NGA ZVRPP



125	SHTET	1911	127/17	ARE	856	100	85600	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
126	BUJAR SADIQ MATRAKU	1911	139/1	ARE	195	100	19500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
127	SHTET	1911	153/6	ARE	366	100	36600	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
128	AVDYL SABRI MATRAKU	1911	258/4	ARE	164	100	16400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
129	SHTET	1911	258/5	ARE	81	100	8100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
130	FILE MEHMETALI MATRAKU	1911	258/6	ARE	210	100	21000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
131	DEFRIM MEHMETALI MATRAKU	1911	258/8	ARE	308	100	30800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
132	QAZIM FEIM MATRAKU	1911	258/9	ARE	73	100	7300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
133	FERIT QAZIM MATRAKU	1911	258/10	ARE	90	100	9000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
134	SHTET	1911	258/11	ARE	81	100	8100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
135	TRENDAFIL AGUSH MATRAKU	1911	258/12	ARE	102	100	10200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
136	SHTET	1911	258/13	ARE	117	100	11700	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
137	BEZAT AGUSH MATRAKU	1911	258/14	ARE	101	100	10100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
138	FERIT QAZIM MATRAKU	1911	258/15	ARE	108	100	10800	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
139	YLLI AGUSH MATRAKU	1911	258/16	ARE	110	100	11000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
140	ZYFER PASHO MATRAKU	1911	258/17	ARE	67	100	6700	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
141	FILE MEHMETALI MATRAKU	1911	258/43	ARE	310	100	31000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
142	DEFRIM MEHMETALI MATRAKU	1911	258/42	ARE	216	100	21600	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
143	NJAZ MYFTAR MATRAKU	1911	258/44	ARE	607	100	60700	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
144	KADRI MEHMETALI MATRAKU	1911	258/48	ARE	36	100	3600	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
145	SHTET	1911	250/2	TRUALL	498	198	98604	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
146	FARI VAIT MATRAKU	1911	250/1	ARE	44	100	4400	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
147	SHTET	1911	250/4	ARE	60	100	6000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
148	SHTET	1911	230/1	TRUALL	166	198	32868	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
149	SHTET	1911	251/1	TRUALL	3117	198	617166	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
150	XHAFAER FAIK XHAFAERI	1911	251/4	ARE	81	100	8100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
151	SHTET	1911	251/5	ARE	352	100	35200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
152	SHTET	1911	130	KULLOTE	1083	83	89889	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
153	SHTET	1911	132/3	ARE	1470	100	147000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
154	SHTET	1911	202/17	ARE	143	100	14300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
155	GEZIM SEJDIN XHAFAERI	1911	202/16	ARE	103	100	10300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
156	AMET ALIM XHAFAERI	1911	202/14	ARE	96	100	9600	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
157	HYSNI SHABAN XHAFAERI	1911	199/18	ARE	451	100	45100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
158	SHTET	1911	259/10	ARE	116	100	11600	KONFIRMUAR NGA ZVRPP



159	SHTET	1911	258/54	ARE	232	100	23200	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
160	SHTET	1911	49/26	KULLOTE	991	83	82253	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
161	SHTET	1911	250/7	TRUALL	403	198	79794	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
162	SHTET	1911	390/1	ARE	701	100	70100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
163	THANAS PANDI MENKSHI	1911	371/2	ARE	35	100	3500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
164	RIZA QEMAL HOXHA	1911	69/3	ARE	605	100	60500	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
165	IPAKONFIRMUAR	1911	149/1	ARE	287	100	28700	IPAKONFIRMUAR
166	IPAKONFIRMUAR	1911	367	ARE	136	100	13600	IPAKONFIRMUAR
167	IPAKONFIRMUAR	1911	230/2	ARE	115	100	11500	IPAKONFIRMUAR
168	IPAKONFIRMUAR	1911	230/3	ARE	16	100	1600	IPAKONFIRMUAR
169	IPAKONFIRMUAR	1911	230/4	ARE	52	100	5200	IPAKONFIRMUAR
170	IPAKONFIRMUAR	1911	230/5	ARE	63	100	6300	IPAKONFIRMUAR
171	IPAKONFIRMUAR	1911	230/7	ARE	201	100	20100	IPAKONFIRMUAR
172	IPAKONFIRMUAR	1911	230/13	ARE	103	100	10300	IPAKONFIRMUAR
173	IPAKONFIRMUAR	1911	221/1	ARE	67	100	6700	IPAKONFIRMUAR
174	IPAKONFIRMUAR	1911	202/7	ARE	242	100	24200	IPAKONFIRMUAR
175	IPAKONFIRMUAR	1911	199/11	ARE	272	100	27200	IPAKONFIRMUAR
176	IPAKONFIRMUAR	1911	171/30	ARE	307	100	30700	IPAKONFIRMUAR
	Fshati Strelce, Bashkia Maliq							
177	SHTET	3523	429/4	ARE	1527	83	126741	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
178	SHTET	3523	408	ARE	1290	100	129000	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
179	SHTET	3523	401	ARE	171	100	17100	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
180	SHTET	3523	409/1	ARE	1023	100	102300	KONFIRMUAR NGA ZVRPP
181	IPAKONFIRMUAR	3523	391	ARE	117	100	11700	IPAKONFIRMUAR
182	SHTET	3523	387/1	ARE	1262	100	126200	IPAKONFIRMUAR
	TOTALI						7,048,907	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë